

VENDIM
Nr. 632, datë 30.7.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 568, DATË 17.7.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, MËNYRËN E ORGANIZIMIT
DHE TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të nenit 59, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 568, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në tekstin e vendimit, togfjalëshi “... e Turizmit dhe Mjedisit ...” zëvendësohet me “... e Mjedisit ...”.

2. Pika 4, e kreut II, shfuqizohet.

3. Në kreun III bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas shkronjës “ç”, të nënpikës 5.2, shtohen shkronjat “d” dhe “dh”, me këtë përmbajtje:

“d) përgatitjen e raporteve periodike të të dhënave mjedisore;

dh) përgatitjen dhe ndjekjen e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit;”;

b) Nënpikat: 5.4, 5.4/1, 5.4/2 dhe 5.4/3 shfuqizohen.

4. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Agjencitë rajonale të mjedisit kryejnë detyrat, si më poshtë vijon:

a) Verifikimin e informacionit të aplikimeve për t’u pajisur me VNM/deklaratë/leje mjedisi;

b) Mbajtjen dhe përditësimin e regjistrave me të dhënat për instalimet e lejeve të kategorive “A” e “B” që ndodhen brenda territorit ku shtrihet fusha e kompetencave të tyre;

c) Koordinimin, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mjedisore në nivel rajoni, si dhe raportimin/përcjelljen e informacionit në drejtorinë e përgjithshme, në funksion të krijimit të sistemit të integruar të informacionit mjedisor, në nivel kombëtar;

ç) Koordinimin e veprimtarisë dhe bashkëpunimin me strukturat përgjegjëse për mjedisin në njësitë e vetëqeverisjes vendore.”.

5. Pas pikës 3, të kreut IV, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Nëpunësit civilë aktualë të AKM-së, të cilët kryejnë funksione inspektuese, trajtohen sipas dispozitave kalimtare të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”.

II. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama